

Raport: Komisioni për arsim, shkencë,  
teknologji, kulturë, rini dhe sport

---

# Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë

---

Prishtinë, shkurt 2017



Raport: Komisioni për arsim, shkencë,  
teknologji, kulturë, rini dhe sport

---

# Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë

---

Prishtinë, shkurt 2017



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



Ky hulumtim u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e kësaj kampanje është përgjegjësi e D + dhe nuk pasqyron pikëpamjet e USAID-it, të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

E drejta autoriale © 2017 e D+.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjëformë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, inçizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit. Ju lutem kontaktoni [info@dplus-ks.org](mailto:info@dplus-ks.org).

# PËRMBAJTJA

Hyrje.....	2
Qëllimi i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit.....	3
Metodologjia.....	4
Aktivitetet e Grupit Punues në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit.....	4
Zbatueshmëria e Ligjit.....	7
Rekomandimet.....	13

# SHKURTESAT

D+	Demokraci Plus
Komisioni	Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport
KQVR	Këshilli Qendror i Veprimit Rinor
KLVR	Këshilli Lokal i Veprimit Rinor
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
OJQ	Organizatë Jo-qeveritare
QR	Qendra Rinore

## HYRJE

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport (në tekstin e mëtejme Komisioni) ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë (në tekstin e mëtejme Ligji).

Ligji është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 30 shtator 2009 dhe ka hyrë në fuqi me dekret presidencial të datës 19 tetor 2009, është publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 60/2009 më 05 nëntor 2009. Që nga ajo kohë, ky ligj nuk është amendamentuar, e as nuk është monitoruar zbatimi i tij nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Ky ligj përcakton përgjegjësitë e institucioneve të qeverisjes qendrore dhe lokale ndaj të rinjve dhe organizatave rinore në fushat përkatëse të rregulluara me këtë ligj; përgjegjësitë themelore për fuqizimin e sektorit rinor në Kosovë dhe përkrahjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje; punën vullnetare dhe edukimin joformal të të rinjve; si dhe udhëzimin për licencimin e qendrave rinore.

Komisioni, në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit , ka autoritet të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve brenda fushës dhe përgjegjësitë të tij. Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 02 gusht 2016, vendosi të mbikëqyrë zbatimin e Ligjit nr.03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë. Për këtë qëllim, Komisioni mori vendim për formimin e Grupit Punues, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë do të mbikëqyrë nivelin e zbatimit të këtij ligji. Grupi Punues përbëhet nga pesë anëtarë: Salih Morina, kryesues, Nait Hasani, Ismajl Kurteshi, Shukrije Bytyçi dhe Teuta Haxhiu– anëtarë.

Procesi i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit është mbështetur nga organizata joqeveritare Demokraci Plus (D+).

<sup>1</sup> Kuvendi i Kosovës, Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, 2010, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rr\\_K\\_RK\\_29\\_04\\_2010\\_1.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rr_K_RK_29_04_2010_1.pdf)

# QËLLIMI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË LIGJIT

Qëllimi i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr.03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë është vlerësimi i zbatueshmërisë së tij në praktikë. Me anë të mbikëqyrjes është synuar që nga vizitat në institucione lokale dhe qendrore, si dhe organizimin e fokus grupeve dhe dëgjimeve publike, të mblidhen të dhënat lidhur me zbatimin e këtij ligji, si dhe të vlerësohet nëse MKRS dhe Komunat e Kosovës janë duke i përmbushur obligimet që dalin nga ky ligj.

Fushëveprimi i këtij ligji përcakton përgjegjësitë e institucioneve të qeverisjes qendrore dhe lokale ndaj të rinjve dhe organizatave rinore në fushat përkatëse të rregulluara me këtë ligj; përgjegjësitë themelore për fuqizimin e sektorit rinor në Kosovë dhe përkrahjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje; punën vullnetare dhe edukimin joformal të të rinjve; udhëzimin për licencimin e qendrave rinore etj. Përmes këtij ligji të rinjve u jepet e drejta për vetorganizim dhe punë vullnetare në organizata dhe grupe të tjera formale dhe joformale, gjithashtu e drejta e votimit dhe zgjedhjes në trupa të ndryshëm të përfaqësimit rinor.

Përveç të drejtave që të rinjtë gëzojnë nga ky ligj, janë të përcaktuara edhe përgjegjësitë e tyre. Të rinjtë duhet të respektojnë parimet e paqes, të drejtësisë, të mirëkuptimit ndërmjet njerëzve që kanë për qëllim mirëqenien dhe zhvillimin në Republikën e Kosovës, si dhe të respektojnë barazinë dhe dinjitetin e të gjithëve të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Qëllimet kryesore të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr.03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë janë:

1. Vlerësimi i përgjithshëm i zbatimit të Ligjit;
2. Vlerësimi i nxjerrjes dhe zbatimit të legjislacionit sekondar - akteve nënligjore nga MKRS me qëllim të zbatimit të këtij ligji;
3. Vlerësimi i shkallës së përmbushjes së obligimeve nga MKRS;
4. Vlerësimi i shkallës së përmbushjes së obligimeve nga komunat e Kosovës;
5. Vlerësimi i efekteve dhe pasojave të moszbatimit efektiv të Ligjit.

## METODOLOGJIA

Në funksion të realizimit të qëllimeve të sipërpërmendura, Grupi Punues në bashkëpunim me Demokraci Plus (D+) ka ndërmarrë hapat si vijon:

- Ka përgatitur Planin e Veprimit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit;
- Ka përgatitur një Hulumtim bazik mbi Ligjin;
- Hartimin e një pyetësoi për MKRS dhe Komunat me pyetje për zbatimin e ligjit nga ana e këtyre institucioneve;
- Identifikimin e legjislacionit sekondar - akteve nënligjore të nxjerra si detyrim i Ligjit;
- Analiza e përputhshmërisë së akteve nënligjore me Ligjin;
- Takime me zyrtar nga MKRS, (ministrin dhe zyrtarët e tjerë përgjegjës për zbatimin e ligjit
- Takime me kryetarët e komunave dhe zyrtarët përgjegjës për Rini (Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Suharekë, Skenderaj, Shtime, Kamenicë, Viti dhe Klinë);
- Organizimin e 3 (tre) Dëgjimeve Publike në qytete të ndryshme të Kosovës (Prishtinë, Pejë dhe Ferizaj);
- Organizimin e 5 (pesë) fokus grupeve nga D+ që kanë shërbyer në ofrimin e të dhënave më të detajuara në hartimin e këtij raporti (Prishtinë, Prizren, Pejë, Graçanicë dhe Mitrovicë).

## AKTIVITETET E GRUPIT PUNUES NË MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT

Grupi punues aktivitetet e tij i ka zhvilluar në bazë të planit të veprimit, i cili përcakton aktivitetet, kohën e realizimit të tyre dhe mënyrën e raportimit. Grupi punues, gjatë gjithë procesit të mbikëqyrjes së ligjit, realizoi këto aktivitete:

- Takime të grupit punues, me qëllim të koordinimit dhe planifikimit të aktiviteteve;



- Takime me zyrtarë në MKRS;
- Vizita dhe takime me kryetarë të komunave dhe zyrtarët lokal për rini;
- Organizimi i tri dëgjimeve publike;
- Organizimi i pesë fokus grupeve;
- Raportim në mbledhjen e Komisionit mbi aktivitetet e zhvilluara.

Grupi i Punës, në fillim të punës së tij ka përgatitur një pyetësor për MKRS-në dhe 11 Komunitat e Kosovës me pyetje të caktuara për sfidat në zbatimin e Ligjit. Përgjigjet janë marrë nga MKRS-ja dhe 11 komunitat, dhe janë përfshirë në këtë raport.

Grupi i Punës me qëllim që të shihet niveli i zbatueshmërisë së Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë nga ana e institucioneve qendrore dhe lokale, ka realizuar 12 vizita në nivele të ndryshme. Grupi i Punës ka vizituar komunitat e lartcekura, ku është informuar nga afër për nivelin e zbatimit të Ligjit dhe sfidat që kanë komunitat gjatë zbatimit të tij. Në këto takime është debatuar në lidhje me edukimin joformal, pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje, mbështetjen financiare, punën vullnetare dhe organizimin e trupave rinore në komunitat përkatëse.

Pas vizitave të tilla, Grupi i Punës ka realizuar një takim pune në MKRS, si institucioni qendror që ka në kompetencën e saj zbatimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve vartëse për implementimin e këtij ligji. Dëgjimet publike janë realizuar në Pejë, Ferizaj dhe në Prishtinë dhe kanë pas për qëllim që të konsultohen edhe hisedarët tjerë që preken me këtë ligj. Organizatat rinore (KQVR-të dhe KVRL-të), zyrtarët rinorë lokalë dhe qendror, OJQ-të rinore dhe mediat kanë qenë pjesëmarrës në takimet e tilla. Me asistencën e D+, janë organizuar pesë fokus grupe në Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Graçanicë dhe Pejë ku është diskutuar me të rinjtë rreth njohurive që ata kanë rreth këtij ligji, cilat janë pengesat në zbatimin e tij, si dhe cilat janë rekomandimet e tyre për përmirësimin e gjendjes aktuale të të rinjve etj.

## Vizitat në terren dhe aktivitetet e tjera

V	Institucioni	Përfaqësues	Data e takimit
1	Vizitë në Skenderaj dhe Mitrovicë	<b>Skenderaj</b> - Fadil Nura – Nënkryetar i Komunës, Hajriz Koca - Drejtor i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe Xhevat Dervishi - Zyrtar për Rini. <b>Mitrovicë</b> - Agim Bahtiri – Kryetar i Komunës, Tafil Peci - Drejtor i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe Fahri Jashari - Zyrtar për Rini (Mitrovicë)	26.9.2016
2	Vizitë në Shtime, Suharekë dhe Prizren	<b>Shtime</b> – Naim Ismajli – Kryetar i Komunës, Fatmire Ferati – Drejtore e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe Selim Zeqa- Zyrtar për Rini <b>Suharekë</b> - Sali Asllanaj – Kryetar i Komunës dhe Nuhi Llugaxhiu- Drejtor i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport. <b>Prizren</b> – Ramadan Muja - Kryetar i Komunës, si dhe përfaqësues nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.	30.9.2016
3	Vizitë në Gjakovë dhe Klinë	<b>Gjakovë</b> – Mimoza Kusari - Kryetare e Komunës, përfaqësues nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport. <b>Klinë</b> – Enver Berisha – Nënkryetar i Komunës, Kristina Lazri, Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.	18.10.2016
4	Vizitë në Kamenicë, Gjilan dhe Viti	<b>Kamenicë</b> – Begzad Sinani -Kryetar i Komunës, Venera Dermaku- Rexha - Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport dhe Bajram Mavriqi- Zyrtar për Rini. <b>Gjilan</b> – Lutfi Haziri- Kryetar i Komunës dhe Genc Mustafa, udhëheqës i Njesisë për Rini. <b>Viti</b> – Sokol Haliti- Kryetar i Komunës, Kaltrina G. Sylejmani- Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.	3.11.2016
5	Vizitë në Prishtinë	<b>Prishtinë</b> - Shpend Ahmeti- Kryetar i Komunës, Besart Vllahinja - Drejtor i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.	24.11.2016
6	Vizitë në MKRS	Kujtim Shala – Ministër, Faton Peci - Këshilltar për Rini, Xhevat Bajrami - Drejtor i Departamentit të Rinisë.	10.11.2016
7	Dëgjimi Publik në Pejë	Kryetari i Komunës – Gazmend Muhaxheri, zyrtarët komunal për rini, organizata rinore lokale (KQVR dhe KVRL), OJQ-të rinore, mediat etj.	4.11.2016
8	Dëgjimi Publik në Ferizaj	Kryetari i Komunës – Muharrem Sfarqa, zyrtarët komunal për rini, organizata rinore nga rajoni i Ferizajt dhe Gjilanit (KQVR dhe KVRL), OJQ-të rinore, mediat etj.	22.11.2016
9	Dëgjimi Publik në Prishtinë	Organizata rinore nga rajoni i Prishtinës (KQVR dhe KVRL), OJQ-të rinore, organizata të tjera vendore dhe ndërkombëtare, mediat etj.	16.12.2016
10	Pesë fokus grupe (Prishtinë, Prizren, Pejë, dhe Mitrovicë)	Të rinjtë e rajoneve të Prishtinës, Prizrenit, Pejës dhe Mitrovicës	

# ZBATUESHMËRIA E LIGJIT

Ligji përcakton përgjegjësitë e institucioneve të qeverisjes qendrore dhe lokale ndaj të rinjve dhe organizatave rinore për:

- a). Fuqizim dhe pjesëmarrje të të rinjve në vendimmarrje;
- b). Punën vullnetare;
- c). Licencimin e qendrave rinore;
- d). Edukimin joformal të të rinjve.

Grupi i Punës gjatë aktiviteteve mbikëqyrëse ka evidentuar se për zbatim të këtij ligji, MKRS-ja ka nxjerrë udhëzimet administrative si në vijim:

- **Udhëzim Administrativ Nr. 9/2010 për Procedurat e Themelimit dhe Funkcionimit të Këshillave të Veprimit Rinor;** që përcakton përgjegjësitë procedurat për themelimin dhe funksionimin dhe forma e regjistrimit të këshillave të veprimit rinor në Kosovë.
- **Udhëzim Administrativ Nr. 10/2010 për Punën Vullnetare të të Rinjve;** që ka për qëllim rregullimin e të drejtave, detyrimeve dhe procedurave, lidhur me punën vullnetare të të rinjve, si dhe punën e Komisionit për zbatimin e punës vullnetare të të rinjve).
- **Udhëzim Administrativ Nr. 11/2010 për Licencimin e Qendrave Rinore;** që përcakton procedurat e licencimit të Qendrave Rinore nëpër komuna. Ky udhëzim administrativ në përgjithësi përmban dispozita të qarta, mirëpo zbatimi i tij në praktikë mund të shihet vetëm pas vizitave në terren nëpër komuna.
- **Udhëzim Administrativ Nr. 12/2010 për Edukimin Joformal të të rinjve;** që ka për qëllim riafirmimin e pjesëmarrjes dhe fuqizimin e të rinjve në politikat sektoriale përmes ofrimit të edukimit joformal për të rinjtë.

Grupi i Punës gjatë procesit të monitorimit ka konstatuar se Qeveria nuk ka nxjerrë aktin nënligjor sipas nenit 6, paragrafi 2 i cili parasheh: “Qeveria me akt nënligjor do të përcaktojë ministritë kyçe, përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni”. Grupi Punues nga aktivitetet e zhvilluara dhe informatat e marra nga palët e interesit, ka vlerësuar se mosnxjerrja e këtij akti nënligjor ka vështirësuar zbatimin e ligjit.

## a. Fuqizimi dhe pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje

Këshilli Qendror i Veprimit Rinor (KQVR) është formacion këshillues për çështje rinore, që përfaqëson interesat e organizatave rinore tek institucionet e pushtetit qendror dhe te mekanizmat rinorë ndërkombëtarë. Përgjegjësitë e KQVR-së bazohen në parimin e barazisë dhe të pjesëmarrjes së barabartë për të gjithë dhe rregullohen me akt nënligjor.

Në kuadër të monitorimit të veprimtarisë së KQVR-së është vërejtur se ky institucion është funksional, ka të zgjedhura organet e saj dhe ka aktivitete të herëpashershme.

Financimi për KQVR-në bëhet nga MKRS, i cili është i vogël dhe përfshinë vetëm funksionimin bazë të KQVR-së. Ky buxhet nuk garanton mbajtjen e ndonjë aktiviteti të veçantë nga ana e KQVR-së. Financimi vjetor i KQVR-së sillet nga 10,000 deri në 12,000 euro në vit, shumë kjo simbolike për të financuar aktivitetet vjetore, zhvilluar strategji apo implementuar plane të veprimit.

Grupi i Punës gjatë procesit të monitorimit ka evidentuar mangësi të çështja e raportimit vjetor të KQVR-së për aktivitetet e zhvilluara dhe raportimin financiar.

Gjatë monitorimit Grupi i Punës ka konstatuar se Konferenca Vjetore për Rininë e Kosovës e paraparë të organizohet nga KQVR-ja, në bashkëpunim me MKRS-në, nuk është organizuar siç parashihet në Udhëzimin Administrativ nr.9/2010.

Këshilli i Veprimit Rinor Lokal (KVRL) është formacion këshillues i organizatave rinore që veprojnë në nivelin lokal dhe përfaqësojnë interesat e organizatave rinore dhe të rinjve tek institucionet e pushtetit lokal.

Përgjegjësitë e KVRL-së janë fuqizimi i organizatave rinore të Komunës ku ato veprojnë, përgatitja e planeve të veprimit për rininë, promovimi i vizionit të të rinjve, shkëmbimi i përvojave ndër organizatat joqeveritare rinore, bashkëpunimi për çështjet me interes të rinisë me institucionet e tjera publike dhe private.

Në kuadër të monitorimit është konstatuar se KVRL-të janë themeluar në shumicën e komunave të Kosovës, me përjashtim të katër komunave në veri të vendit.

Nga vizitat dhe takimet e realizuara, është konstatuar se KVRL-të ballafaqohen me disa vështirësi në funksionimin e tyre në disa komuna, siç është përkrahja e ulët, mungesa e organizatave rinore, mungesa e organeve legjitime, organizimi i zgjedhjeve, etj.

Grupi i Punës ka konstatuar se Konferenca Vjetore për Rininë e Kosovës e paraparë të organizohet nga KVRL në bashkëpunim me Komunën nuk është organizuar siç parashihet në Udhëzimin Administrativ nr.9/2010.

## b. Puna vullnetare

Në takimet e realizuara nga Grupi i Punës, ndër çështjet kryesore të adresuara ishte çështja e vullnetarizmit, respektivisht njohja e punës vullnetare dhe mosha që Ligji përcakton për angazhimin dhe punën vullnetare.

Me Ligj përcaktohen parimet e përgjithshme të punës vullnetare dhe njohja e punës vullnetare si përvojë pune. Me Udhëzimin Administrativ nr.10/2010, për punën vullnetare të të rinjve, MKRS përcaktohen obligimet e organizuesit të punës vullnetare, obligimet e vullnetarit, regjistrimin e vullnetarëve, lidhjen e marrëveshjes për punë vullnetare, mbajtjen e regjistrave dhe lëshimin e librezave për punë vullnetare si dhe themelimin e Komisionit të përhershëm për punë vullnetare.

Grupi i Punës ka konstatuar se ky udhëzim administrativ nuk është zbatuar në praktikë, për shkak se MKRS-ja nuk ka bërë data bazën për regjistrin e vullnetarëve si dhe nuk ka themeluar Komisionin e përhershëm për punë vullnetare si organ përgjegjës për zbatimin e këtij udhëzimi administrativ.

Grupi i Punës nga takimet e realizuara me organizatat rinore ka konstatuar se mosha e përcaktuar prej 15 deri 24 vjeç për punë vullnetare, sipas Ligjit

paraqet pengesë për punë të të rinjve, të cilët pas kësaj moshe janë të interesuar për punë vullnetare. Pas përfundimit të procesit të monitorimit të Ligjit, MKRS-ja ka nxjerr Udhëzimin Administrativ nr.01/2016 për punën vullnetare të të rinjve, i cili e shfuqizon Udhëzimin Administrativ nr. 10/2010 për punën vullnetare të të rinjve.

## c. Licencimi i Qendrave Rinore

Ligji ka përkufizuar Qendrat Rinore si institucionet tejet të rëndësishme për fuqizimin e rinisë dhe zbatimin e programeve dhe politikave rinore. Këto qendra ofrojnë hapësirë për programet dhe mundësitë për përmbushjen e detyrave që lidhen me zhvillimin fizik, mental, shoqëror dhe shpirtëror të të rinjve, ofron hapësirë, resurse dhe mundësi për zhvillimin e veprimtarive edukative joformale, si dhe të veprimtarive të tjera të planifikuara nga të rinjtë.

Për funksionimin e këtyre qendrave, Ligji ka përcaktuar edhe procedura të licencimit të tyre nga drejtoritë komunale përgjegjëse për rini, sipas llojit dhe natyrës së saj, duke marrë parasysh strukturën dhe programet.

Nga aktivitetet e realizuara të Grupit të Punës, konstatohet se funksionimi i Qendrave Rinore dallon nga një komunë në tjetrën. Në disa komuna, si Peja, Rahoveci apo Suhareka, Qendrat Rinore janë funksionale dhe me shumë programe dhe aktivitete të realizuara, disa komuna tjera si Klina, Skenderaj apo Kamenica, qendrat e tyre i kanë gati tërësisht jofunksionale. Qendrat Rinore të cilat funksionojnë më mirë dhe kanë një numër solid të aktiviteteve janë kryesisht për shkak se financimi i tyre bëhet nga donatorët e huaj, raste të tilla janë Peja, Rahoveci dhe Suhareka. Në rastet kur Qendrat Rinore nuk kanë ndonjë mbështetje nga komuniteti i donatorëve të huaj dhe funksionojnë vetëm nga përkrahja e institucioneve lokale, veprimtaria e tyre është e kufizuar dhe me nivel të ulët të shërbimeve për të rinjtë.

Një ndër arsyetimet e zyrtarëve komunalë për mosfunksionimin e qendrave

rinore, ishte mungesa e mjaftueshme e buxhetit për angazhimin e resurseve njerëzore për mirëmbajtjen e qendrave rinore.

## d. Edukimi joformal i të rinjve

Grupi i Punës në takimet e realizuara ka adresuar çështjen e edukimit joformal të të rinjve si një mundësi që synon zhvillimin e edukimit joformal për të rinjtë në fushat si të: demokracisë, tolerancës, humanizmit, mbrojtjes së ambientit, identitetit historik, zhvillimit kulturor, ndryshimeve ndërkulturore, dialogut shoqëror dhe politik, kujdesit shëndetësor dhe të edukimit fizik, punësimit dhe promovimit për të rinj.

Gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të Ligjit është vërejtur se mungon organizim i planifikuar i edukimit joformal si nga institucionet qendrore po ashtu edhe ato lokale. Të gjitha aktivitetet që janë bërë në këtë drejtim kanë qenë ad hoc dhe si pjesë e projekteve të ndryshme, por asnjëherë si iniciativë e veçantë.

Grupi i Punës konstaton se Ministria nuk ka themeluar Komisionin e Përhershëm për Edukim të të Rinjve, sipas nenit 7 të Udhëzimit Administrative nr.12/2010 për Edukimin Joformal të të Rinjve, si përgjegjës për zbatim të këtij udhëzimi.

## e. Buxheti për sektorin e rinisë

TNga vizitat dhe dëgjimet publike të realizuar në komuna, Grupi i Punës është informuar se për sektorin e rinisë nuk ka kod të veçantë buxhetor dhe se mbështetja financiare për të gjitha përgjegjësitë që dalin nga Ligji për sektorin e rinisë, ndahen nga linjat buxhetore për subvencione. Kjo shumë materiale ndryshonte varësisht nga kapacitetet financiare të komunave përkatëse. Mbështetje për sektorin e rinisë e vështirësonte dhe më shumë fakti se nga e njëjta linjë buxhetore (subvencione), komunat ndanin buxhet

edhe për fushat tjera si: sport, kulturë etj. Nisur nga fakti se pjesa më të madhe nga kjo shumë i ndahej klubeve sportive, atëherë mbështetja për sektorin e rinisë në shumicën e komunave është minimale.

Grupi i Punës vlerëson se mbështetja financiare për sektorin e rinisë do të lehtësonte dhe mundësonte zbatimin e plotë të dispozitave të këtij Ligji, duke u mundësuar komunave krijimin e një kodi të veçantë buxhetor dhe jo siç është aktualisht në kuadër të linjës buxhetore për subvencione.

Gjithashtu, Grupi i Punës ka vërejtur se komunat, financimin e projekteve rinore e bëjnë pa ndonjë plan, rregullore apo monitorim të efektshëm të zbatimit të këtyre projekteve. Organizatat rinore kanë theksuar se në kuadër të ndarjes së buxhetit për projekte rinore, komunat mund të kenë anshmëri në baza politike, familjare apo të tjera. Kjo mundësohet nga fakti se subvencionet ndahen në bazë të diskrecionit të kryetarit apo drejtorit përkatës.

Për të shmangur këto praktika dhe për të siguruar transparencë në financimin e projekteve të organizatave rinore, kërkohet që komunat në fillim të vitit të hartojnë plane, ndajnë buxhetin dhe të formojnë komisione, të cilat do të bënin vlerësimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të projekteve.




## REKOMANDIMET

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2017, pas raportimit të Grupit të Punës, nxjerrë këto rekomandime:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të hartojë ligj të veçantë për punën vullnetare;
2. Qeveria e Republikës së Kosovës të nxjerrë akt nënligjor sipas nenit 6 paragrafi 2, me të cilin përcaktohen ministritë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të këtij Ligji;
3. MKRS-ja të themelojë Komisionin për punë vullnetare, sipas nenit 11 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2016 për Punën Vullnetare të të Rinjve;
4. MKRS-ja të themelojë Komisionin e Përhershëm për Edukim Joformal të të Rinjve, sipas nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr.12/2010 për Edukimin Joformal të të Rinjve;
5. MKRS-ja në bashkëpunim me KQVR-në të organizojnë Konferencën Vjetore për Rininë e Kosovës, sipas Udhëzimit Administrativ nr.9/2010 për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillave të Veprimit Rinor në Kosovë;
6. Ministria e Financave në bazë të kërkesave të Komunave të ndajë kod të veçantë buxhetor për Rininë;
7. MKRS-ja dhe Komunitat të harmonizojnë strategjitë dhe planet e veprimit për çështjet rinore më qëllim të fuqizimit të rinisë;
8. Komunitat të sigurojnë financim të rregullt për Qendrat Rinore dhe KVRL-të;
9. Komunitat të bëjnë licencimin e së paku një Qendre Rinore;
10. Komunitat të shpallin konkurs për projektet rinore;
11. Komunitat të themelojnë komisione të pavarura për vlerësimin e projekteve të organizatave rinore.

**Kryetari i Komisionit**  
**Nait Hasani**





# PËR DEMOKRACI PLUS

Demokrasi Plus (D+) është organizatë e pavarur dhe jo për përfitim, e themeluar nga një grup aktivistësh të cilët besojnë fuqishëm në vlerat demokratike dhe në një shoqëri demokratike në Kosovë. Qëllimi parësor i Demokrasi Plus është që të mbështesë vlerat e praktikat demokratike si dhe politikatat që do të kontribuojnë edhe më tutje në zhvillimin e një qytetarie aktive.

Tri shtyllat kyçe të Demokrasi Plus, janë: Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit, Partitë Politike dhe Zgjedhjet si dhe të Drejtat e Njeriut dhe Çështjet Sociale.

Për informata të mëtutjeshme, ju lutem shihni:



[www.dplus-ks.org](http://www.dplus-ks.org)



[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)